

VENDIM
Nr. 581, datë 31.8.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR, PËR TË
NDËRMARRË PROCEDURAT, PËR DHËNIE ME KONCESION/PPP PËR
PROJEKTIN “PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË INFRASTRUKTURËS SË
ÇELËSAVE PUBLIKË (PKI)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si autoritet kontraktor për të ndërmarrë dhe zhvilluar procedurat për dhënie me koncesion/PPP, për projektin e propozuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, “Për ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës së çelësave publikë (PKI)”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama